

ALBANA MEMA**NDIKIMI ITALIAN NË KRIZAT POLITIKE
TË VITEVE 1920-1924****Kompromisi politik me Italinë - Kongresi i Durrësit,
rrjedhojat e tij**

Ndikimi i fuqive evropiane tek elita politike shqiptare do të fillonte me përpjekjet e kësaj të fundit për të gjetur aleatë në mbrojtjen e kauzës së saj në Konferencën e Paqes. Kështu vitet 1918-1920, ishin vitet e një debati të gjerë ndërmjet elitës shqiptare për orientimin politik në kuadër të zhvillimeve ndërkombëtare. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm luajtën edhe organizatat shqiptare të diasporës si shoqëria “Vatra” në Amerikë, shoqëria anglo-shqiptare, e themeluar në shkurt të vitit 1918, shoqëritë shqiptare të Zvicrës, Turqisë, Egjiptit, Partia Politike në SHBA etj.¹

Lëvizja Kombëtare Shqiptare, në këtë kohë, arriti një kompromis historik me politikën italiane, për mbrojtjen e interesave shqiptare. E gjendur përballë një izolimi të madh ndërkombëtar, ajo i bëri disa lëshime qeverisë italiane, të cilat cenonin karakterin e pavarur të një shteti kombëtar. Rezultat i kompromisit me italianët, ishte mbajtja e një Kongresi Kombëtar në Durrës, për të zgjidhur sfidat politike, me të cilat përballlej Shqipëria. Por, brenda këtij kompromisi ekzistonin kundërshti të thella midis dy palëve për shkak se objektivat e tyre përputheshin vetëm pjesërisht. Kështu, nga shumë burime, vërtetohet se kur u mbledh asambleja në Durrës italianët ngulnin këmbë që të mos formohej një qeveri, po të zgjidhej një komision.² Pra, ky Kongres, pas një sërë diskutimesh, vendosi krijimin e një qeverie e të një delegacioni që do ta përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Paqes, si dy institucione, përgjegjëse për çështjen shqiptare.

¹ Muin Çami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes, 1919-1920*, Tiranë: Kristalina-KH, 2015, f. 71-72; Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 214-215.

² Mehdi Frashëri, *Kujtime, Vitet 1913-1933*, Tiranë: OMSCA-1, 2005, f. 59.

Kongresi i Durrësit, ishte manifestimi më serioz i politikës shqiptare të kohës, por institucionet e dala prej tij nuk treguan efikasitetin e duhur, për shkak të kontrollit dhe presionit italian, i cili erdhi gjithnjë në rritje. Pikën kulminante, imponimi italian, do ta kishte me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë së Durrësit e autoriteteve italiane, thelbi i së cilës, ishte kontrolli i qeverisë së Durrësit nga Komisariati i Lartë Civil Italian. Dështimi i qeverisë shqiptare, si në rrafshin e politikës së brendshme ashtu edhe në atë të jashtme, lidhet me ndikimin e drejtpërdrejtë të Italisë. Kjo bëri që ndaj qeverisë së Durrësit, me të drejtë, të vërshojë një lumnajë akuzash. Mosfunksionimi i saj u kushtëzua edhe nga një arsye tjetër, angazhimi jashtë vendit i figurave kryesore të saj si: Turhan Pashë Përmeti, Luigj Bumçi, Mehmet Konica etj. Shqipëria në këtë kohë u përball edhe me probleme të brendshme, ku padysim ishin të pranishme edhe ndikimet e huaja.

Megjithkëtë, ngritja e qeverisë dhe krijimi i delegacionit për në Konferencën e Paqes, ishin dëshmi e përpjekjeve për të forcuar pozitën kombëtare të shqiptarëve dhe për të ndërtuar institucione sa më efektive. Këto institucione, kishin në përbërje veprimtarë të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, gjë që ndihmoi në synimin e saj, për ndërtimin e një qeverie, me tipare kombëtare, pavarësisht se sfera e veprimit të saj ishte e kufizuar nga italianët të cilët mbanin të pushtuar vendin.

Më vonë, karakteri jo i plotë i pavarësisë së institucioneve të krijuara, do të shkaktonte një krizë përfaqësimi, e cila ishte pjesë e krizës ku ndodhej çështja shqiptare në atë kohë. Dëshmi e këtij fakti ishte edhe përfaqësimi në Konferencën e Paqes me disa delegacione joqeveritare. Kjo qasje diplomatike rezultoi si një ogur jo i mirë për çështjen shqiptare, pasi, përveç të tjerash, u shoqërua me mosmarrëveshje ndërmjet tyre.

Në kushtet kur pavarësia dhe integriteti territorial i Shqipërisë në Konferencën e Paqes ishin në rrezik serioz, mosfunksionimi i mirë i delegacionit në Konferencën e Paqes, kontrolli i qeverisë së Durrësit nga italianët, pengimi prej tyre dhe mosfunksionimi i Pleqësisë Kombëtare të zgjedhur nga Kongresi i Durrësit, shkaktuan një krizë të thellë politike brenda vendit por, edhe të funksionimit dhe legjitimitetit të institucioneve shqiptare. Këto rrethana u shndërruan kështu në faktorë kushtetues, që shtynë dhe bënë legjitime, përpjekjet e pjesës më të ndërgjegjshme dhe më të avancuar të nacionalizmit shqiptar, për të organizuar një kongres të ri të përmasave kombëtare.

Kongresi i Lushnjës - sfida e parë madhore kundër politikës italiane

Thirrja e një kongresi kombëtar shihej si një mundësi për të dalë nga kjo krizë e rrezikshme e çështjes shqiptare. Një argument tjetër për thirrjen e kongresit, ishte fakti se qeveria e Durrësit nuk ishte njohur nga asnjëra prej fuqive të tjera. Gjithashtu, përveç mosnjohjes, ata nuk mbanin asnjë kontakt me këtë qeveri, kjo edhe sepse italianët kontrollonin të gjitha komunikimet e informacionet brenda dhe jashtë Durrësit.³ Thirrja e këtij Kongresi kishte edhe një motiv institucional. Ky ishte dështimi apo refuzimi i qeverisë së Durrësit, për të vepruar nën kontrollin e Pleqësisë e cila, nuk ishte mbledhur prej një kohe të gjatë.

Elita politike shqiptare në këtë periudhë, jo vetëm që nuk e kishte siguruar një konsensus të plotë kombëtar për hapin e ri që po ndërmernte, por do të ndeshte edhe në një rezistencë serioze nga krahu italo-fil, qoftë për shkak të bindjeve politike, por edhe të ambicieve personale. Krahu politik i ish qeverisë së Durrësit, shumë shpejt do të dilte në minorancë, por ai do të vijonte të ushtronte një ndikim politik të rëndësishëm, kryesisht negativ, në procesin e formimit dhe konsolidimit të institucioneve të reja kombëtare. Ky do të bëhej edhe baza e mbështetjes së politikës italiane për të vijuar betejën e saj për dominim politik në Shqipëri.

Këtu është vendi të nënvizojmë faktin se, thirrja e këtij kongresi dhe përgatitjet për të, nuk ishin iniciativa thjesht dhe vetëm e individëve që më parë nuk kishin pasur ndonjë lidhje midis tyre. Bie qartësisht në sy fakti se, epiqendra dhe promotori kryesor i këtyre përpjekjeve, ishte një organizatë e fshehtë politike, me tharm të spikatur nacionalist, që quhej “Krahu Kombëtar”. Ajo ishte themeluar që në vitin 1914, sipas modelit të organizatave të mëparshme xhonturke që kishin vepruar në Perandorinë Osmane.*

³ Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 1996, f. 29.

* Kjo organizatë, do të luante një rol të rëndësishëm në zhvillimet politike dhe në themelimin e menaxhimin e institucioneve kombëtare. Më vonë, pas Kongresit të Lushnjës, për shkak të ndikimit të saj të fuqishëm në këto institucione dhe mënyrës së si vepronte, do të etiketohej nga kundërshtarët e saj politikë, me emrin “Klika”.

Italianët u përpoqën ta pengonin këtë ndryshim, duke i kundërvënë shqiptarët me njëri tjetrin, por, nuk ia arritën qëllimit. Afirmimi i karakterit të pastër kombëtar të shtetit shqiptar, do të realizohej në ballafaqim me politikën italiane, në vitin 1920. Edhe një pjesë e qeverisë së Durrësit, u përpoq që ta pengonte mbajtjen e Kongresit të Lushnjës. Kjo përbënte, një përplasje institucionale, e cila, ishte shumë e rrezikshme, pasi mund të degjeneronte në një konflikt politik dhe më keq akoma, në një konflikt civil, i cili, në këtë fazë ku gjendej çështja shqiptare, do të ishte katastrofik për fatet e Shqipërisë. Pra, presioni dhe ndikimi italian e mbartin edhe këtë rrezik të madh. Fatmirësisht, ky skenar nuk ndodhi dhe shqiptarët shpëtuan edhe një herë nga kjo grackë e rrezikshme. Por, edhe pse rezultati i Kongresit të Lushnjës, do të ishte fatlum, presioni italian dhe ballafaqimi me të do të krijonte vështirësi të mëdha dhe një dobësi relative, për institucionet e reja kombëtare qeverisëse, të krijuara prej tij.

Në kampin e qeverisë së Durrësit dhe njëherësh kundërshtarë të Kongresit të Lushnjës nuk spikat ndonjë organizatë politike shqiptare nacionaliste ose jo, por, vetëm krerët e tri familjeve të njohura çifligare, ku më i fuqishmi midis tyre ishte Myfit Libohova, i pasuar nga Sami Vrioni dhe Fejzi Alizoti si dhe individë të veçantë. Pra, arkitektura politike e opozitës ndaj Kongresit të Lushnjës ishte tepër konservatore në mbrojtjen e pikëpamjeve të tyre, pasi dominues ishin vetëm disa përfaqësues të familjeve çifligare.

Por, Kongresi i Lushnjës nuk pati tendencë bllokimi vetëm nga politikanë shqiptarë, si Libohova e kolegë të tij, por edhe nga shtetet e interesuara drejtpërsëdrejti për përfitime politike dhe territoriale në Shqipëri. Kështu, si të interesuar kryesorë, për të penguar iniciativat politike që gjallëronin lëvizjen kombëtare në Shqipëri, u shfaqën përveç Italisë, edhe Greqia e Jugosllavia si dhe mbështetësit e tyre ndër radhët e Fuqive të Mëdha. Kërkesat kryesore të Italisë ishin: marrja e Vlorës dhe sigurimi i një mandati politik mbi krejt Shqipërinë. Për këtë arsye, ajo u angazhua për të penguar mbledhjen e Kongresit të Lushnjës.⁴ Trupa të rregullta ushtarake, në bashkëpunim me qarqe të qeverisë së Durrësit, veçanërisht me Myfit Libohovën, i krijuan një sërë vështirësish kongresistëve, për të mbërritur në kohë në Lushnjë.

⁴ *Po aty*, f. 32.

Italianët e gjykuan si më oportune për interesat e tyre, që ta shpërndanin Kongresin me anë të forcave të xhandarmërisë shqiptare, duke dashur ta paraqisnin përplasjen midis tyre, si një konflikt civil midis shqiptarëve për pushtet. Por, ky skenar dështoi, si rezultat i kundërshtimit të këtyre forcave për të shpërndarë me dhunë kongresin. Komandantët e tyre morën menjëherë kontakt me kongresin dhe i dhanë pa më të voglin ngurrim sigurimin se do të viheshin në mbrojtje të tij.⁵ Ky, është një shembull i rëndësishëm, i efekteve që po jepte rritja e ndërgjegjes kombëtare në radhët e popullsisë dhe i rëndësisë së saj, për sendërtimin e institucioneve të reja kombëtare. Forcat e xhandarmërisë shqiptare, që refuzuan të shpërndanin me forcë Kongresin e Lushnjës, dëshmuar se tashmë, me gjithë mangësitë, pengesat dhe kontrollin e italianëve dhe politikën personale që bënin disa politikanë të grupuar në qeverinë e Durrësit, ishte krijuar embrioni i një force ushtarake kombëtare, e cila dëshironte të ishte e përgjegjshme dhe besnike vetëm ndaj atdheut të saj dhe interesave të larta kombëtare.

Pra, ato, jo vetëm që shmangën një luftë të mundshme civile, të provokuar nga italianët, jo vetëm mundësuan politikanët e linjës së vendosur kombëtare, që të vijonin përpjekjet e tyre për kapërcimin e ngërçit politik dhe për sendërtimin e një politike dhe të institucioneve kombëtare por, dëshmuar se, tashmë ishte formuar një bërthamë me kapacitetet e duhura njerëzore, e cila mund të shërbente si bazë për formimin e institucioneve ushtarake dhe të sigurisë me tipare kombëtare.

Brenda një harku kohor shumë të shkurtër, Italia vuri në lëvizje njërën plan pas tjetrit për të realizuar synimet e saj, që nga protektorati mbi Shqipërinë deri te aneksimi ushtarak i territoreve të saj me rëndësi strategjike.

Nuk ishte vetëm procesi në vazhdim i njohjes ndërkombëtare të Shqipërisë që e detyroi Italinë të ndryshojë taktikë. Në Shqipëri në këtë kohë kishte filluar një lëvizje kombëtare me nuanca të theksuara antiitaliane.⁶

Në këtë periudhë, një rol aktiv, krahasuar me fuqitë e tjera evropiane, filloi të luajë Anglia, një shtet i fuqishëm dhe me një prestigj të padiskutueshëm ndërkombëtar. Politika e qeverisë britanike në janarin e

⁵ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 193.

⁶ Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1924*, Tiranë: UET Press, 2013, f. 23.

vitit 1920, ndonëse zyrtarisht bëri hapin më të rrezikshëm drejt copëtimit të Shqipërisë me kompromisin anglo-franko-italian të 13 janarit 1920⁷, shfaqti edhe një tendencë disi të maskuar që, nëse kjo marrëveshje nuk do të funksiononte, të eksploroheshin edhe rrugë të tjera për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Ky drejtim i padukshëm i politikës britanike do të përbënte një sfidë për objektivat madhore italiane në Shqipëri. Anglezi Morton Eden, i gjendur në Shqipëri në atë kohë, filloi të flasë hapur me nacionalistët shqiptarë për mundësinë e dëbimit të italianëve.⁸ Përfshirja e Anglisë në çështjen shqiptare, ndonëse në këtë periudhë në mënyrë të padukshme e disi misterioze, pasi politika zyrtare britanike ende nuk kishte lëvizur nga pozicionet e saj të mëparshme, inkurajoi deri diku disa qarqe politike shqiptare. Eden nuk u gjend rastësisht në Shqipëri në prag të këtyre zhvillimeve të rëndësishme dhe, tashmë ka të dhëna burimore se, qoftë ai, qoftë koloneli Philips në Shkodër, inkurajuan disa krerë shqiptarë të formonin një qeveri të re dhe t'i kundërviheshin politikës së rrezikshme që po ndiqte Roma zyrtare. Pavarësisht se qëndrimet e tij mund të konsiderohen jozyrtare, ato padyshim patën së paku rol nxitës. Vlerësimet e Edenit për kongresin, nënkuptojnë se ai ishte optimist e në favor të tij.⁹ Roli i Edenit në këtë zhvillim të rëndësishëm kombëtar, qartësohet me largimin e tij nga Shqipëria pas kongresit, pasi mendohej se mund të zbulohet nga italianët.¹⁰

Pra, nga sa theksuam më lart mund të thuhet se, institucionet e reja kombëtare, në momentin fillestar të krijimit të tyre, në radhë të parë kongresi dhe më tej ato që do të dilnin prej tij, patën një mbështetje të maskuar dhe të limituar ndërkombëtare. Megjithëse ishte e tillë, përderisa ekzistonte një vakuum thuajse total i kësaj mbështetjeje në arenën

⁷ Si pasojë e bisedimeve diplomatike, më 13 janar 1920, u arrit kompromisi anglo-franko-italian, ku parashikohej që Italia të merrte Vlorën dhe një mandat mbi Shqipërinë, Jugosllavia Shqipërinë Veriore, përfshirë edhe Shkodrën, kurse Greqia përfitonte Gjirokastrën dhe Korçën. Kjo marrëveshje, ishte padyshim shkatërruese për Shqipërinë por, ajo nuk u vu në jetë, për shkak të mosmarrëveshjeve midis Jugosllavisë dhe Italisë, në Çështjen Adriatike dhe ndërhyrjes amerikane, ku Presidenti Wilson, vendosi të mos e njihje marrëveshjen e lartpërmendur të shteteve evropiane dhe kërkoi që Çështja e Adriatikut të ndahej nga çështja shqiptare.

⁸ Eqrem Bej Vlora, *Kujtime 1912-1925*, vëll. II, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2001, f. 440.

⁹ Pranvera Dibra, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: Ada, 2006, f. 110.

¹⁰ *Po aty*, f. 113.

ndërkombëtare dhe ngaqë Britania e Madhe ishte Fuqia me ndikim më të madh në Ballkan dhe në Evropë, ajo pati një vlerë inkurajuese dhe rëndësi të padiskutueshme.

Kongresi i Lushnjës, mund të vlerësohet si themeli i procesit të ringritjes së institucioneve kombëtare, në fazën e re ku kishte hyrë shteti shqiptar në vitet 1920. Vlera kryesore e tij ishte krijimi i një shteti unik, kombëtar dhe afetar.

Në fakt, kongresi ishte mbledhur pikërisht për të tejkaluar qëndrimin që po mbante qeveria e Durrësit, ndaj problemit të mprehtë të zgjidhjes së çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes dhe konkretisht për shkak të kufizimit të opsioneve që ofronte ajo për çështjen kombëtare, si rezultat i përpjekjeve të konsumuara të saj, për ta zgjidhur atë në pajtim me politikën italiane. Nga ana tjetër, kongresi e kuptonte se ndryshimi radikal i përfaqësimit politik në Konferencën e Paqes, ishte i mbarsur me rreziqe të humbjes së vijimësisë së këtij përfaqësimi dhe të atij legjitimiteti të cunguar, që ishte krijuar nga kjo përfaqësi, në vitin 1919. Gjithashtu, mund të krijoheshin edhe kundërshti të tjera, të cilat mund ta komplikonin edhe më tej çështjen shqiptare. Por, duhet nënvizuar se, përbërja e këtij komisioni nga patriotë të njohur e të besueshëm ndaj çështjes kombëtare, e njëkohësisht të aftë për të negociuar për interesat kombëtare në arenën ndërkombëtare, krijonte mundësinë e ruajtjes së këtij përfaqësimi, pasi ky delegacion i kishte kapacitetet të zbatonte në aspektin diplomatik, politikën e re kombëtare të Kongresit të Lushnjës.

Pra, Kongresi i Lushnjës, përveç karakteristikave të përgjithshme si një kongres rithemelues i shtetit shqiptar dhe me frymë antiimperialiste, ishte një lëvizje politike e elitës nacionaliste shqiptare për të balancuar presionin italian mbi qeverinë shqiptare dhe për këtë shkak ishte dukshëm me një frymë antiitaliane, pasi ai iu kundërvu dy objektivave themelore të politikës italiane: Protektoratit mbi Shqipërinë dhe aneksimit të Vlorës. Pikërisht për shkak të kësaj sfide madhore ndaj politikës italiane, Roma, para dhe pas kongresit, u përpoq ta godiste atë. Por, për më tepër Italia nuk e ndali presionin dhe diversionin e saj kundër qeverisë së parë që doli nga Kongresi i Lushnjës, e cila iu përmbajt me vendosmëri parimeve themelore të këtij kongresi: ndërtimit të një shteti shqiptar me tipare të spikatura kombëtare dhe ndjekjes së një politike kombëtare të fqinjësisë së mirë.

Megjithëse, kongresi në tërësi sfidoi politikën aneksioniste italiane, kjo nuk do të thotë se ndikimi italian ishte sfumuar tërësisht. Madje, në

radhët e delegatëve të Kongresit, të Senatit që doli prej tij dhe madje edhe në Këshillin e Naltë, Italia kishte influencat e veta, të cilat do t'i shfrytëzonte për interesat e politikës së saj në muajt dhe vitet në vijim.

Lufta e Vlorës -goditja më e rëndë e objektivave të politikës italiane

Kulmi i ballafaqimit midis Italisë dhe shtetit të ri shqiptar do të arrinte me Luftën e Vlorës, fitorja e së cilës, shënonte një etapë të re në afirmimin e shtetit kombëtar shqiptar. Me këtë betejë, shqiptarët i treguan botës, se ishin të aftë të organizoheshin, të luftonin dhe se tashmë ishin të përgatitur për ta krijuar vetë shtetin e tyre kombëtar.

Politika italiane mori goditjen më madhore në Luftën e Vlorës, në verën e vitit 1920. Përfundimi me sukses i Luftës së Vlorës, padyshim, ishte një zhvillim madhor, drejt avancimit të statusit të Shqipërisë si shtet i pavarur. Më 2 gusht 1920, pas përpjekjeve, të cilat zgjatën për dy muaj, një marrëveshje u nënshkrua në Tiranë ndërmjet qeverisë shqiptare dhe të dërguarit të jashtëzakonshëm italian, sipas së cilës, Italia hoqi dorë nga dy objektivat e saj kundrejt Shqipërisë: Protektoratit mbi shtetin shqiptar dhe aneksimit të Vlorës.

Lufta e Vlorës, sigurisht që ka një rëndësi të madhe historike pasi, duke iu kundërvënë politikës pushtuese italiane, në një moment shumë të pafavorshëm për Italinë, shqiptarët dëshmuan edhe një vullnet ushtarak, gatishmërinë dhe aftësinë për të përdorur forcën në mbrojtje të atdheut dhe lirisë së tyre. Kjo bëri që Italia, të vendosej para dilemës ose t'i kundërviej me armë popullit shqiptar ose të pranonte rivendosjen e pavarësisë së tij, të njohur ndërkombëtarisht më 1913. Ajo zgjodhi rrugën e dytë dhe në këtë mënyrë u këput hallka kryesore, e atij zinxhiri fatal që kishte mbërthyer çështjen shqiptare dhe rivendosjen e pavarësisë së Shqipërisë. Por, kjo nuk do të thotë se ky ishte faktori i vetëm.

Këtu, mendoj se, ndikuan një sërë faktorësh, të cilët nuk duhen minimizuar ose nënvleftësuar. Së pari, ndikoi interesi politik i disa Fuqive të Mëdha. Kundërshtimi amerikan për të mos lejuar copëtimin e mëtejshëm të Shqipërisë dhe kundërshtimi i traktateve të fshehta të lidhura nga Fuqitë evropiane para luftës. Ndikoi edhe riorientimi i politikës britanike, drejt rinjohjes së pavarësisë së Shqipërisë, që lidhej edhe me refuzimin amerikan dhe ndryshimin e koniunkturës politike, në Ballkan, pas luftës. Londra duket se ripërcaktoi interesat e saj, të cilat

ishin të dorës së dytë, në raport me Shqipërinë. Krijimi i Lidhjes së Kombeve, i këtij institucioni ndërkombëtar, me reputacion të gjerë në opinionin evropian, ishte një faktor i rëndësishëm, favorizues. Lidhja, u pa nga një pjesë e diplomacisë së kohës, si një mekanizëm i cili, do të ndihmonte organizimin e shtetit të ri të dobët shqiptar, duke zbutur kështu një nga dilemat themelore të Fuqive të Mëdha, që lidhej me mbijetesën e këtij shteti dhe mundësinë e vetëqeverisjes së shqiptarëve.

Afirmimi i karakterit kombëtar të shtetit shqiptar dhe ruajtja e territorit të tij u bë edhe në ballafaqim me politikën jugosllave. Jugosllavia, për të njëjtat arsye si Greqia, interesohej në ndalimin e çdo lëvizjeje politike me karakter shtetformues në Shqipëri, si parakusht për jetësimin e platformave të tyre politike. Sikurse edhe dy shteteve të tjera, Italisë e Greqisë, asaj nuk i interesonte konsolidimi i shtetit shqiptar, e aq më pak fuqizimi i linjës së ndjekur prej lidhshpimit kosovar me qëndrim në Shqipëri. Jugosllavia i druhej mbështetjes që institucionet kombëtare të ngritura rishtas prej këtij kongresi, mund t'i jepnin çështjes së Kosovës. Interesi parësor i Jugosllavisë, ishte mosdepërtimi i Italisë në Ballkan. Në këtë mënyrë, mund të konkludojmë se, politikës së ekuilibruar dhe të barazlartuar të shtetit të ri shqiptar ndaj tyre, fqinjët e Shqipërisë iu përgjigjën me një politikë të ashpër presioni, e cila sfidonte karakteristikat kombëtare dhe asnjansë të këtij shteti.

Lufta e Vlorës, në aparence, u drejtua nga organizata politike-ushtarake të papërfshira zyrtarisht në establishmentin qeverisës. Ndërsa, në fakt, qeveria dha një ndihmë të madhe të maskuar por, efektive në mbështetje të kësaj lufte. Ky skenar rezultoi i suksesshëm. Pra, në këtë rast kishte një bashkëveprim të koordinuar mirë midis qeverisë si një institucion politik qendror dhe Komitetit “Mbrojtja Kombëtare”, një organizatë politike ushtarake jashtë sferës qeverisëse dhe institucionale zyrtare të vendit.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes shqiptaro-italiane të 2 gushtit 1920 u tejkalua rreziku eminent dhe pësuan goditje objektivat maksimaliste italiane kundrejt Shqipërisë, por kjo nuk do të thotë se ndryshoi rrënjësisht kjo politikë. Përkundrazi, ajo do të orientohej tani në dy objektiva të reja themelore, të cilat do të karakterizonin gjithë periudhën e vështirë të viteve 1920-1924:

- a. Në zgjerimin e influencës politike në Shqipëri, duke përdorur të gjitha mjetet e format e mundshme, me objektivin madhor që

qeveritë shqiptare të ktheheshin në vegla politike të Romës dhe të merrnin një karakter të spikatur filoitalian;

- b. Përpjekjet në arenën ndërkombëtare që Italia të fitonte një pozitë të privilegjuar në Shqipëri, e cila në esencë të ishte një formë efikase protektorati. Synimi themelor i politikës italiane tashmë ishte sigurimi i pozitave politike dhe ekonomike monopoliste në këtë vend të vogël ballkanik. Kjo politikë, do të kishte pasoja të rënda mbi shtetin e ri shqiptar, të cilat do t'i trajtojmë më tej.

Me gjithë rezultatet e arritura në procesin e konsolidimit të shtetit shqiptar gjatë gjysmës së parë të vitit 1920, nga fundi i këtij viti, mbeteshin ende probleme të mprehta që prisnin zgjidhje. Shtroheshin veçanërisht dy probleme të rëndësishme në fushën e politikës së jashtme: përcaktimi përfundimtar i kufijve dhe ripohimi i statusit të Shqipërisë si shtet i pavarur.¹¹

Por, në këtë periudhë përveç mosmarrëveshjeve klanore e individuale që ishin mbisunduese, u shfaqën edhe kundërshti politike parimore siç ishte konflikti i qeverisë me një pjesë të “Komitetit të Kosovës” për çështjen e zbarimit të armëve të sjella nga aventurieri nacionalist italian D’Annuzio, të cilat drejtuesit e KMK synonin t’i fusnin në Kosovë për të fuqizuar luftën çlirimtare antiserbe atje.

Edhe në këtë rast këto mosmarrëveshje nuk u menaxhuan në mënyrë të arsyeshme dhe racionale. Në vend që të çonin në gjetjen e alternativave më të favorshme për mbrojtjen e interesave kombëtarë dhe të popullsisë shqiptare të mbetur nën sundimin e huaj, ato e dobësuan më tej faktorin shqiptar. Para së gjithash, ata cenuan shtetin kombëtar, si një instrument themelor dhe prioritar i mbrojtjes së interesave kombëtare. Kështu, shumë nga drejtuesit e “Komitetit të Kosovës” si: B. Curri, Qerim Begolli, Xhemal Prishtina, Hasan Prishtina dhe, prapa këtyre, gjithë masa e emigrantëve kosovarë, kishin bindje se, duke u mbështetur pas politikës italiane do të fitohej Kosova e robëruar. Kjo shpresë i bashkoi ata me italo-filët dhe, në atë kohë jashtëzakonisht të vështirë, i shtuan radhët e kundërshtarëve të qeverisë. Por, të gjitha këto lëvizje, kishin karakter antiqeveritar, në kuptimin që synonin rrëzimin nga pushteti të forcave politike që qeverisnin Shqipërinë, qoftë edhe të zgjedhur nga votuesit.

¹¹ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1876-1926*, Tiranë: Albin, 2003 (ribotuar, 2010), f. 312.

Qëllimi i tyre ishte marrja e pushtetit, pavarësisht mekanizmave thellësisht antiligjore e antipolitike.

Grushti i shtetit i dhjetorit të vitit 1921, implikimi dhe roli i legatës italiane

Trazirat politike të dhjetorit të vitit 1921, si dhe vendimet e marra pas saj, nga parlamenti e qeveria kundër organizatorëve të grushtit të shtetit, krijuan një pakënaqësi të madhe në radhët e kundërshtarëve të Zogut dhe këto vendime, sado të moderuara që ishin, shërbyen si shkaqe kryengritjesh antiqeveritare. Në pamje të parë, dukej se ishte krijuar perspektiva për një opozicion të moderuar. Por, meritë e së shkuarës dhe mendësia shqiptare për hakmarrje, ishin më të fuqishme se arsyeja e nevojave të konsolidimit të shtetit. Në fakt, duhet gjykuar me kujdes, situata në të cilën u gjendën institucionet përfaqësuese të vendit, në ato momente. Atyre iu mungonte eksperiencia, tradita ligjore dhe kapacitetet institucionale, për ta zgjidhur situatën në një mënyrë që, nga njëra anë të ruhej stabiliteti i vendit dhe në anën tjetër, të merreshin masa të tilla ligjore, të cilat të mos lejonin përsëritjen e ngjarjeve të tilla në të ardhmen.¹²

Ali Këlcyra, deputet i Gjirokastrës, pranonte se këto ngjarje e futën në rrezik gjithë bazën e shtetit, dhe i cilësonte ato si një “dramë”. Sipas tij, si çdo lëvizje e madhe në jetën shoqërore dhe kjo e fundit në Shqipëri, kishte shkaqet, burimet dhe pasojat e saj. Duke vazhduar më tej në analizën e tij, ai deklaronte: “një nga shkaqet e para të ngjarjeve të fundit, janë dhe intrigat e huaja. Dy rryma politike, ka sot në Shqipëri, për sa u përket Qeverive të huaja. E para është ajo e partisë ekstremiste italofile, e cila kërkon me çdo mënyrë t’u lidhë Shqipërinë politikërisht, moralisht dhe ekonomikërisht me Italinë. Kjo parti, e ndihmuarë prej Qeverisë Italiane, kërkon me çdo mjet të vijë në fuqië e të marrë frenat e Shtetit në dorë. Po, këtë qëllim që ajo nuk mundi t’u arrijë në zgjedhjet e fundit, kërkoj t’u realizojë këtë herë me një Grusht Shteti. Nga ana tjetër, është Partia Nacionaliste e mbështetur në ndërgjegjen e Kombit Shqiptar, e cila me gjithë që dëshiron të jetë në raporte më të mira si me Italinë ashtu dhe me fqinjët dhe me gjithë shtetet e tjerë, do, me çdo mënyrë të mbajë independencën politike, ekonomike dhe neutralitetin e

¹² Për më tepër shih edhe: Albana Mema, “Situata politike në Shqipëri pas krizës së rëndë të vitit 1921 dhe kryengritjes së marsit 1922”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2014.

*plotë tek e cila sheh vetëm shpëtimin e atdheut.*¹³ Në fakt, Këlcyra mund të thuhet se “i kishte rënë pikës” me këtë analizë duke zbuluar thelbin e asaj që nuk thuhej hapur por, që ishte mjaft e kuptueshme dhe do të verifikohej në ngjarjet e mëtejshme.

Të dhëna tepër interesante lidhur me grushtin e shtetit, të dhjetorit të vitit 1921, jepte përfaqësia e legatës italiane në Shqipëri. Ajo ndonëse fshihte rolin e saj në këtë komplot, sqaronte disa aspekte me rëndësi të grushtit të shtetit. Me anë të një përmbledhjeje kronologjike të zhvillimit të krizave të qeverisë shqiptare në dhjetor të vitit 1921, legata mbretërore e Italisë në Durrës e paraqiste situatën në Shqipëri në këtë periudhë mjaft të zymtë. Ajo nënvizonte, pa më të voglin dyshim, se grushti i shtetit ishte kryer nga Këshilli i Naltë. Por, ajo na jep disa të dhëna të tjera edhe më të rëndësishme, për synimet që kishte dashur të realizonte Regjenca, përmes këtij grushti shteti. Synimi kryesor, sipas saj, ishte parandalimi i ardhjes së “Krahut Kombëtar”, “Partisë Popullore” dhe nëpërmjet tyre i Ahmet Zogut në pushtet. Jo vetëm kaq por, ata nuk donin në asnjë mënyrë që Zogu dhe “Partia Popullore” të vinin në pushtet në këtë moment tepër vendimtar, kur do të përcaktohej përfundimisht forma e regjimit. Është e kuptueshme që bashkë me përcaktimin e formës së regjimit, do të konsolidohej për një kohë të gjatë në pushtet, partia ose grupi politik, që do të kishte fuqinë në momentet e hartimit të kushtetutës së parë të shtetit shqiptar.

Pra, arsyeja kryesore e këtij veprimi nuk ishte interesi për formën e regjimit por, fuqia që do të instalohej përmes përcaktimit të saj përfundimtar. Legata italiane rendit në plan të dytë, armiqësinë personale midis Aqif Pashës dhe A. Zogut, gjë që duket më se e vërtetë pasi ky fakt konfirmohet nga shumë burime të tjera. Përfaqësia italiane në Shqipëri e informonte në këtë mënyrë Romën: “Grushti i shtetit, i vendosur nga Regjenca, ka marrë arsye nga synimi i kësaj të fundit për t’i prerë iniciativat grupeve dhe elementëve që të shpien tek Ahmed Zogolli, të cilët priren të hedhin themelet në mënyrë solide në pushtetin qeveritar dhe publik në përgjithësi në pritje të vendimeve të ardhshme të afërta rreth sistemimit institucional të vendit. Paralelisht me motivin e

¹³ *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, nr. 2, dt. 14 Kallinduer 1922, “Ngjarjet e fundit, A. Këlcyra - Deputet i Gjirokastrës”.

sipërshprehur, arsyeja personale e çonte kreun e Regjencës, Aqif Pashën, të dilte kundër planeve të Ahmet Zogollit...”¹⁴

Këtu është vendi të nënvizojmë me forcë faktin se edhe italianët ishin të përfshirë në këtë aferë. Ata kishin kohë që po luftonin për të krijuar një qeveri sa më të fortë filoitaliane në Shqipëri. Por, për shkak të ngjarjeve të shumta që kishin ndodhur në të shkuarën, në Shqipëri ishte krijuar një rrymë e fortë politike nacionaliste antiitaliane, e cila mishërohej më së shumti në “Partinë Popullore”, “Krahun Kombëtar” dhe në vetë personin e politikanit të fuqishëm, të spikatur dhe në ngjitje të kësaj kohe, A. Zogut.

Politika që italianët kishin ndjekur ndaj qeverisë së Durrësit; politika që kishin ndjekur në Konferencën e Paqes, për shkak të synimit për të aneksuar Vlorën dhe për të marrë mandatin mbi Shqipërinë; kundërshtimi me forcë i mbledhjes së Kongresit të Lushnjës dhe vetë Lufta e Vlorës, do të shtonin frymën nacionaliste antiitaliane në vend. Por, disa nga njerëzit e fuqishëm në vend, të implikuar në grushtin e shtetit, ishin nën influencën italiane. Këta ishin anëtarë të regjencës, Luigj Bumçi, kryeministri i dytë që mori fuqinë pas grushtit të shtetit, Hasan Prishtina, Mustafa Kruja etj.

Pasi përmendte që në fillim të raportit të saj shkaqet e grushtit të shtetit, të favorizuar edhe nga elementë lokalë dhe parlamentarë që ndjeheshin të kërcënuar nga veprimtaria e partisë së Zogut, legata italiane relatonte në mënyrë të detajuar mbi veprimet që u kryen për realizimin e grushtit të shtetit: “Në fillim të dhjetorit, ministri i Financave, Ahmet Dakli, me motivin se nuk pranoheshin nga këshilli i ministrave disa propozime të tij rreth riorganizimit të financave dha dorëheqjen, i pasuar menjëherë nga ministri i Punëve Publike, Zija Dibra. Këta dy persona i përkisnin grupit të Aqif Pashës”.¹⁵ Regjenca, duke marrë shkas nga mungesa e plotësisë së qeverisë dhe nga kriza e pjesshme që u vendos me dorëheqjet e ministrit të Financave dhe të atij të Punëve Publike, Ahmed Dakli dhe Zija Dibra, i drejtoi një letër kryetarit të Këshillit të Ministrave Pandeli Evangjelit, me të cilën, pasi kishin formuluar falenderimet për shërbimet e bëra, e ftonte të jepte dorëheqjen. Pandeli Evangjeli, nxitoi

¹⁴ *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri, Roma (AMAE, Roma), Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 710, img. 0304-0309, 16 janar 1922. Përmbledhje kronologjike e zhvillimit të krizave të qeverisë shqiptare (dhjetor, 1921) nga legata mbretërore e Italisë në Durrës.*

¹⁵ *Po aty.*

duke caktuar deputetët Kolë Thaçi dhe Rexhep Mitrovica, të parin për të mbuluar funksionet e ministrit të Financave dhe të dytin për Arsimin publik, vend ky ende vakant për shkak të mospranimit të detyrës nga ana e të emëruarit të mëparshëm Hilë Mosi. Pasi iu paraqitën Regjencës këto dy emra, nuk u pranuan prej saj.¹⁶ Pra, kuptohet se emërimi i ministrave me simpati për A. Zogun e bëri edhe më të vendosur regjencën në veprimin e saj.

Kryeministri Pandeli Evangjeli iu përgjigj Regjencës se nuk mund të pranonte ftesën për dorëheqje për shkaqet si më poshtë vijojnë: “1. Qeveria rezultonte e plotësuar, me të emëruarit e rinj Kolë Thaçi dhe Rexhep Mitrovica; asnjë dorëheqje nuk mund të shkaktonte assesi krizë; 2. Regjenca nuk kishte pushtet për të refuzuar emërimin e ministrave të veçantë, por vetëm kompetencën për të caktuar kryetarin e këshillit të ministrave; 3. Letra e Regjencës ishte nënshkruar vetëm nga dy regjentë, ndërkohë që anëtarët e këshillit të Regjencës ishin katër, prej të cilëve tre të pranishëm në Tiranë; 4. Qeveria më në fund nuk mund të jepte dorëheqjen, pa një votim parlamentar, të cilit do t’i nënshtrohej në seancën e ardhshme parlamentare të cilën Qeveria vetë kishte parashikuar ta thërriste për datën 15 të muajit (dhjetor)”.¹⁷ Edhe nga ky përshkrim i ngjarjeve që bënin italianët, shihet qartë se argumentet e P. Evangjelit para komplotistëve ishin shumë të ligjshme, të shëndosha e konstruktive por, komplotistët nuk ishin të interesuar për ligjshmërinë, ata donin ta shfrytëzonin këtë moment kritik për të marrë në dorë fuqinë dhe më tej të realizonin planin e tyre. Duhet shënuar se kjo paraqitje ishte e ngjashme me atë që diplomatët britanikë i kishin relatuar Londrës.

Në vazhdim, sipas legatës italiane, Qazim Koculi paraqitet para Regjencës për t’i bërë të ditur se, duke shqyrtuar të gjitha rrethanat, nuk e gjykonte të mundshëm formimin e një kabineti jetësor pa pjesëmarrjen e Zogut dhe propozonte më së paku të ruajë portofolin e ministrit të Brendshëm Bajram Fevziu, i grupit të Zogut. Përmenden shkarazi edhe rrugëzgjdhje të tjera bashkëpunimi me grupin Zogolli. Por, Regjenca nuk pranon të tilla propozime, duke bërë që kryeministri Koculi të refuzojë detyrën e ngarkuar. Në këtë kontekst, legata italiane pohonte: “Me sa duket, nga ana e grupit të elementëve zogollianë, duhet të ishte ushtruar

¹⁶ *Po aty*. Legata italiane pohonte se “është për t’u shënuar se Kolë Thaçi dhe Rexhep Mitrovica kanë simpati për Ahmed Zogun”.

¹⁷ *Po aty*.

drejtpërdrejtë një presion i fortë mbi Koculin, kështu që ky, ose prej frikës personale, ose prej një ndjenje përgjegjësie, ka përfunduar duke u gjendur rob i rrymës, së cilës fillimisht dukej se i kundërvihet”.¹⁸ Ky informacion ka një rëndësi të veçantë, për faktin se shpjegon shkaku e vërtetë, përse Koculi u tërhoq në momentet e fundit nga komploti. Gjithashtu, shumë interesant duket edhe propozimi për kompromis që ai bëri në këto momente kritike.

Frikësimin e Koculit e kanë përmendur edhe burime të tjera shqiptare por, legata italiane na e jep të plotë e të saktë shkaku e tij. Koculi, një pjesëtar egoist i “Krahut Kombëtar” ishte rival i Zogut, ndonëse të dy bënin pjesë në të njëjtën organizatë dhe parti. Por, kundërshtimi i pjesës tjetër të “Krahut Kombëtar”, shumica e të cilëve ishin politikanë nga jugu dhe e grupit që mbështeste Zogun brenda kësaj organizate, me sa duket e frikësuan atë dhe ai ndërroi mendim duke kërkuar formimin e një qeverie kompromisi me “Partinë Popullore” dhe A. Zogun. Ky propozim u kundërshtua me forcë nga krerët e komplotit, Aqif Pasha, armik personal i Zogut dhe grupi italoofil, L. Bumçi, H. Prishtina etj. Kjo tërheqje në momentet kulmore të komplotit desh i kushtoi jetën Koculit nga drejtuesit e grushtit të shtetit. Nga ana tjetër, tërheqja e tij e vuri Aqif Pashën, L. Bumçin dhe H. Prishtinën në një pozitë tepër të vështirë. Po kështu edhe legatën italiane, e cila tashmë vendosi të luante me letra edhe më të hapura. Prandaj, pas Koculit, qeveria iu ngarkua njeriut ndoshta më të besuar të italianëve, Hasan Prishtinës. Këtë emërim dhe këtë zhvillim të ngjarjeve Aqif Pasha, kreu më i fuqishëm i komplotit, nuk e priti mirë por, emërimi i Prishtinës prej tij si kryeministër u bë nga e keqja.

Përveç regjencës, e cila ishte koka e komplotit, duket se ai kishte një shtrirje edhe më të gjerë në radhët e politikanëve shqiptarë. Kështu, përveç grupit të deputetëve kosovarë dhe atyre shkodranë, rezulton se pas grushtit të shtetit qëndronin edhe deputetët e Vlorës, të cilët donin të thërrisnin Asamblenë Kushtetuese, duke mbledhur në Vlorë parlamentin, i cili do të miratonte shpalljen e zgjedhjeve. Përfaqësuesit italianë, vërenin një çarje të thellë politike me baza krahinore dhe madje, parashikonin që në këto momente, edhe një luftë midis veriut dhe jugut. Sipas diplomacisë italiane, “nga Vlora, prej grupit të deputetëve të atjeshëm, është nisur po atë ditë iniciativa për të mbledhur atje

¹⁸ *Po aty.*

parlamentin më datë 15 të muajit (dhjetor), për të vendosur mbledhjen e një Asambleje Kushtetuese dhe për të gjykuar veprimtarinë e Regjencës. Ndërsa Kabineti i ri (i Hasan Prishtinës), në marrëveshje me Regjencën, ka vendosur hapjen e parlamentit në Tiranë më datë 21 të muajit dhe iu ka telegrafuar njoftimin për mbledhjen deputetëve të veçantë. Karakteristika e situatës merr pamje për t'i dhënë momentit shenja paralajmëruese lufte mes veriut dhe jugut të Shqipërisë. Në Shkodër elementë të krishterë në shumicë anojnë në mbështetje të kabinetit të ri. Elementë myslimanë tregohen më të rezervuar, veçanërisht për shkak të emërimit të Gurakuqit të krishterë, si ministër i Brendshëm”.¹⁹

Pas ngjarjeve të mësipërme dhe përmbysjes me dhunë të qeverisë së “Bashkimit të Shenjtë” të kryesuar nga P. Evangjeli, nga komplotistët u krijuan dy qeveri të tjera, të cilat nuk patën jetëgjatësi. Qazim Koculi e Hasan Prishtina u vunë në krye të tyre, por shumë shpejt edhe vetë ata do të kuptonin se kishin gabuar dhe një gabim i tillë do t'u kushtonte edhe karrierën e tyre politike. Eksperiencë që ato patën me drejtimin e qeverive respektive në këtë periudhë, do të dëmtonte në mënyrë të pariparueshme edhe figurën patriotike të secilit prej tyre.

Për ecurinë e këtyre ngjarjeve dramatike, diplomati britanik, Heathcote Smith, njoftonte sekretarin e Jashtëm, Curzon, se përgjegjësi parësor për grushtin e shtetit ishte Aqif Pasha. Ndër të tjera, ai shkruante: “Regjenti, siç duket tani, është marrë vesh për *coup* e tij të 7 dhjetorit me Qazim Koculin, aktori kryesor. Ai u ndodh në Tiranë për shkak të konferencës së prefektëve dhe për sa kohë që shokët dhe qëllimet e tyre ishin të njëjta, Regjenti, zgjodhi atë për të zbatuar programin e tij.”²⁰ Më tej, ai zbulonte edhe një fakt interesant që kishte të bënte me synimet e komplotistëve. Smith pohonte se, “thirrja e menjëhershme e një Asambleje Kushtetuese, do të shoqërohej edhe me zgjedhjen e Sovranit.” Përveç kësaj, Smith shpjegonte edhe arsyet përse Koculi u detyrua shumë shpejt të jepte dorëheqjen. Ai shkruante: “Planet e Regjentit, megjithatë, dështuan. Për arsye personale, personat e afërt me Qazim Beun, duke u frikësuar se ky veprim ishte i destinuar të dështonte, refuzuan të bashkëpunonin.”²¹ Ky raport i Smith, konfirmon edhe raportin e legatës

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *The National Archives, London* (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: *FO*) 371/7330, f. 581-586. Telegram i Heathcote Smith për Curzon, mbi situatën politike në vend, 18 janar 1922.

²¹ *Po aty*.

italiane, të cilin e kemi cituar më lart, e cila pohonte se Koculi u tremb nga presioni i anëtarëve të tjerë të “Krahut Kombëtar” dhe e pa se veprimi i tij nuk kishte shans për sukses. Gjithashtu, për të shpëtuar prej kësaj pozite të rrezikshme, ku e kishte futur veten, ai i propozoi Aqif Pashës kompromis me “Krahun Kombëtar” dhe A. Zogun, të cilin ai e kishte rival kryesor brenda partisë së tij.

Tërheqja e Koculit, i vuri në pozitë tepër të vështirë krerët e komplotit, jo vetëm për faktin se e kishin të vështirë të gjenin një person tjetër të përshtatshëm dhe të gatshëm të merrte përsipër detyrën e një kryeministri ilegjitim, të një qeverie të krijuar pas një grushti shteti por, edhe për faktin se Aqif Pasha nuk mund të llogariste edhe më tej mbështetjen e deputetëve vlonjatë, e cila ishte kaq e rëndësishme për komplotistët, në këto momente tepër dramatike kur ata po luanin rrezikshëm ose “për gjithçka ose për asgjë”. Në lidhje me këto zhvillime Smith raportonte: “Aqif Pasha ishte në një dilemë të rëndë. Ai kishte hedhur poshtë z. Evangjeli me një *coup d’Etat* dhe tani ishte i paaftë të vendoste një kabinet në vend të tij.”²² Pra, sipas Smith, grushti i shtetit ishte i pamenduar mirë dhe dështimi i tij i parë e vuri Regjentin Aqif Pasha në një pozitë tepër të vështirë.

Vlen t’i bëjmë edhe një analizë përbërjes së qeverisë Koculi, pasi përmes saj mund të kuptojmë rrymat e interesuara ose që e kishin mbështetur grushtin e shtetit. Kryeministri Koculi ishte një nga pjesëtarët e fuqishëm dhe me influencë të ‘Krahut Kombëtar’ ose asaj që quhej “Klika” pra edhe i “Partisë Popullore”. Gjithashtu, edhe regjenti Aqif Pasha kishte qenë pjesëtar i fuqishëm i kësaj organizate. Kështu, kuptohet se ky grusht shteti e kishte origjinën kryesore nga radhët e kësaj organizate dhe bëhej për të përmbysur një kryeministër (Pandeli Evangjelin), i cili ishte edhe ai pjesëtar i kësaj organizate por, sigurisht i një rryme tjetër brenda saj. Tërheqja e Koculit provonte gjithashtu faktin se, krahu brenda “Klikës” në këto momente, ishte ende i dobët për të imponuar vullnetin e tij, madje edhe duke u bashkuar me grupet e tjera opozitare, jashtë “Partisë Popullore”. Qeveria kishte në përbërje Ahmet Daklin, i cili ishte besniku ose njeriu i Aqif Pashës dhe nuk i përkiste ndonjë grupi tjetër politik si dhe njërin nga drejtuesit kryesorë të “Partisë Popullore”, liberalin Fan Noli. Pra, edhe ky ishte një tregues se “Partia Popullore” do t’i kishte pozitën e forta në këtë qeveri. Por ajo që bie më

²² *Po aty.*

tepër në sy, duke studiuar përbërjen e kësaj qeverie, ishte përfshirja e elementëve të vendosur filoitalianë si Luigj Gurakuqi dhe Hoxha Kadriu, i cili së bashku me Zija Dibrën, siguronin gjithashtu një përfaqësim të rëndësishëm të “Komitetit të Kosovës” në këtë qeveri.

Nga ky fakt, si dhe nga fakti tjetër i rëndësishëm, se krerë kryesorë të grushtit të shtetit ishin edhe regjenti italo-fil Luigj Bumçi, Hasan Prishtina dhe Mustafa Kruja, dëshmohet se kishte një implikim dhe rol të legatës italiane në nxitjen dhe frymëzimin e grushtit të shtetit. Gjithashtu, mund të kuptohet se kjo përfaqësi, për interesa të politikës dominuese italiane në Shqipëri, po nxiste dhe mbështeste krijimin e aleancave të fshehta opozitare kundër “Klikës” dhe “Partisë Popullore” e cila, që prej Kongresit të Lushnjës, ishte afishuar si jo e orientuar apo e influencuar nga Roma. Këto aleanca, siç shihet nga grushti i shtetit, përbëheshin nga elementë filoitalianë dhe pjesëtarë të veçantë të “Klikës” të pakënaqur nga pushteti që kishin brenda saj. Gjatë gjithë kësaj periudhe duket se politika diversioniste italiane brenda establishmentit politik shqiptar u zhvillua në disa drejtime: 1. përkrahja dhe nxitja e grupeve filoitaliane, financimi dhe fuqizimi i tyre si dhe nxitja e një opsioni të fortë dhe të ashpër të tyre kundër gjithë establishmentit politik që ndiqte vijën e Kongresit të Lushnjës; 2. përpjekjet për të rekrutuar në favor të politikës italiane politikanë të veçantë brenda “Krahut Kombëtar” ose “Partisë Popullore”, e cila ishte forca kryesore qeverisëse e këtyre viteve dhe njëherazi forca më e organizuar politike; 3. dhe çka ishte më kryesorja, nxitja e përçarjeve brenda kësaj organizate me synimin themelor dobësimin dhe shkatërrimin e saj.

Kjo politikë konsistente e qeverisë italiane, kundrejt klasës politike shqiptare dhe shtetit shqiptar, do të kishte pasoja të rënda. Përmes nxitjes së konflikteve personale me motive egoiste brenda “Krahut Kombëtar” si dhe të dasive krahinore e fetare brenda vendit, politika italiane do të bëhej shpirti dhe frymëzimi i fuqishëm i një tensioni dhe konflikti të brendshëm politik, gati permanent dhe një faktor i fuqishëm i jashtëm, që më në fund do të çonte në shkatërrimin e rendit kushtetues në Shqipëri, shkatërrimin e “Krahut Kombëtar” dhe destabilizimin e plotë të vendit.

Përshtypjen negative që bëri grushti i shtetit në qarqet ndërkombëtare, e përshkruante me nota të forta edhe legata shqiptare në Romë. Ndër të tjera, në një raport të saj thuhej: “Këto ndryshime qeverish, të komunikuar në shtyp prej gazetave franceze, duke e paraqitur Shqipërinë në anarshi dhe luftë vëllazënore, kanë bërë

përshtypjen më të keqe, kaqë në shtyp sa dhe në qarqet politike e qeveritare të këtushëm. Kundërshtarët dhe armiqt doemos nuk presin tjetër, veç se si të gjejnë shkaqe për me na skredimtue [diskredituar] e me na kallzue si një komb i pa arrirë për vetqeverrim”. T. Mborja njoftonte se edhe legatat e huaja, ishin të të njëjtit mendim dhe se ardhja e H. Prishtinës në pushtet nuk ishte pritur mirë prej tyre. “Ardhja e Z. Hasan Prishtinës në fuqi dhe mënyra me të cilën e mori (sikundër është marrë vesh këtu në Konsultë) kanë lënë një përshtypje fort të keqe, duke e ditur që ky Zotni ka qenë në marrëveshje me D’Annunzion e duke pasur frikë se, me aktin e parë, do shkakëtonte një luftë me Jugosllavinë. Të këtij mendimi janë dhe disa prej Legatave të huaja”.²³

Përmbysja e qeverisë së H. Prishtinës, krijoi menjëherë një farë çtensionimi si në qarqet e brendshme ashtu dhe në ato ndërkombëtare. Më 22 dhjetor 1921, legata shqiptare në Romë njoftonte: “Rënia e Z. Hasan Prishtinës përgjithësisht ka bërë një përshtypje të mirë, kaqë në Ministerin [qeverinë] italiane sa dhe në Legatat e huaja që ndodhen këtu. Në Konsultë [MPJ të Italisë], që për sot, duan të mbajnë impenjet e dhëna kundrejt Jugosllavis, kishin frikë se Kabineti i Z. Hasan Prishtinës, nuk është i pëlqyer këtu [nga diplomatët e huaj në Romë]. Qeveria italiane, për arsyet e naltpërmenduna, me gjithë zemër nuk donte që ky të ishte në krye të punëve të Jashtme. [Qeveria] këtu i telegrafoi Z. Kastoldit që ta porosite H. Prishtinën të mos ngatërronte punë me Jugosllavinë, t’i këshillonte moderacion dhe të mbante [zbatonte] vendimet e dhëna prej Konferencës së Ambasadorëve dhe prej Lidhjes së Kombevet.”²⁴

Ky ishte qëndrimi publik i qeverisë italiane ndaj kësaj qeverie ilegjitime dhe grushtit të shtetit, i cili s’mund të ishte ndryshe, jo vetëm se ky grusht shteti ishte antikushtetues e ilegal por, edhe se u pa qartë që kishte shumë pak shanse për të siguruar sukses. Por, është e pamundur që, në prapaskenë, legata italiane dhe Farnezina (Ministria e Punëve të Jashtme) të mos e ketë inkurajuar grushtin e shtetit dhe krijimin e qeverive Koculi e Prishtina pas tij, duke angazhuar dhe njëkohësisht

²³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: *V.*) 1921, dosja (më tej: *D.*) 3, fl. 60-61. Përshtypje e legatës shqiptare në Romë për situatën e Shqipërisë, mbi kabinetin e Hasan Prishtinës, i Ngarkuari me Punë ad interim, T. Mborja, 16.12.1921.

²⁴ *Po aty*, fl. 61-62. Telegram i legatës shqiptare në Romë, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi përshtypjet për rënien e H. Prishtinës, i Ngarkuari me Punë ad interim, T. Mborja, 22 dhjetor 1921.

kompromentuar disa nga politikanët më të fuqishëm dhe të rëndësishëm që ishin nën ndikimin e saj.

Në një telegram të legatës së Shqipërisë në Romë, mbi ngjarjet e fundit në vend, jepeshin përshtypjet e këqija që kishin bërë në legatat e ndryshme të akredituara në Romë, ndryshimet e shpeshta të qeverive dhe të Regjencës. “Me gjithë këtë ndjej detyrën t’Ju çfaq përshtypjen që nder ZZ. e naltpërmendun ka bërë rrëzimi i Monsinjor Bumçit prej Rexhencës dhe ay i Z. Pandeli Vangjelit prej Kryeministrit; duke e konsideruar të parin si një përfaqësues më me rëndësi të komunitetit katolik dhe të dytin si një kristian i mosduruar prej Mohamedanëve në krye të Shtetit t’onë. Eshtë tepër t’Ju them, Zoti Ministër, se këtë opinion e kundërshtova, duke thënë se në Shqipni mbretëron vetëm shpirti nacionalist e liberal. Këtu u përpoqëm dhe në shtyp si e si të mos s’gjatej e të komentohej gjendja e Shqipnis me ngjyra të zeza, duke u kundërshtuar dhe përgenjështuar lajmet tendencioze të armiqvet t’anë.”²⁵

Zhvillimet politike të viteve 1922-1923 në këndvështrimin italian

Pas dështimit të grushtit të shtetit të dhjetorit 1921 dhe pas ndryshimit të Këshillit të Naltë, Xhafer Ypi u ul në karrigen e kryeministrit, duke i lënë dorë të lirë në qeverisje në postin e ministrit të Brendshëm, Ahmet Zogut. Kjo qeveri e ngarkonte në fakt Zogun si njeriun më me shumë pushtet në vend, për shkak të rolit që mori ky i fundit për shtypjen e grushtit të shtetit. Me gjithë situatën e vështirë që ishte krijuar, Xhaferr Ypi dhe kolegët e tij, iu vunë detyrës së tyre të rëndë me guxim dhe vendosmëri. Një prej veprimeve të pakta të kabinetit të Xhaferr Ypit, ishte kërkesa drejtuar Italisë që të tërhiqte trupat e saj nga Shkodra, e cila u plotësua në fund të marsit.²⁶

Stabilizimi i qeverisjes pas grushtit të shtetit solli rezultate shumë pozitive. Ky ndryshim i madh politik, sigurisht do të çonte një hap përpara procesin e fuqizimit të pozitës ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Por, ky zhvillim nuk u përshtatej objektivave të politikës italiane. Ngjarjet në Shqipëri në këtë periudhë dhe tendencat politike më të fundit

²⁵ AMPJ, V. 1921, D. 80. Korrespondencë e MPJ me përfaqësitë shqiptare mbi botimin nga shtypi i huaj për ngjarjet politike në Shqipëri. Telegram i legatës shqiptare në Romë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme Tiranë, i Ngarkuari me Punë, T. Mborja, 29 dhjetor 1921.

²⁶ Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 310-311.

i ndiqte me vëmendje edhe përfaqësuesi i shtetit italian në Shkodër. Në një raportim të kapitenit të Korvetës, U. Perricone, të datës 9 janar 1922, thuhet: “Krijimi i qeverisë së re shqiptare ku Ahmed Bej Zogolli është *magna pars* (person me rëndësi parësore), ka bërë t’u pëlqejë shumë jugosllavëve, e natyrisht edhe Konsulli i Francës është treguar i kënaqur prej kësaj”.²⁷

Në këtë raport, për sa i përket A. Zogut, thuhej se ai “nuk ka pasur kontakte me serbët, por është kufizuar të intimidojë në Prefekturë [e Shkodrës] parinë e qytetit, duke i ftuar të mos merren me politikë, të mos bëjnë mbledhje apo të mbajnë ligjërrata dhe duke u thënë atyre se mund t’ua paraqesin idetë e tyre lirisht vetëm anëtarëve të qeverisë. Natyrisht të gjithë heshtën dhe asnjë nuk kundërshtoi, as ndonjë nga paria katolike që në ditët e mëparshme kishte shfaqur dëshirën e kotë për shpalljen e Asamblesë Kushtetuese.”²⁸

Kapiteni Perricone jepte edhe një fakt me shumë rëndësi: Ai nënvizonte, kundërshtimin e Zogut për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese në këto momente, pasi e shihte të rrezikshëm për Shqipërinë ballafaqimin e republikanëve dhe monarkistëve, në këtë fazë të pjekurisë politike të popullit shqiptar. “Për këtë të fundit (Asamblenë Kushtetuese) Ahmed Beu tregohet tejet armiqësor, ka thënë madje se nuk dëshiron të dëgjojë të flitet për të, me pretekstin se, pasi në një kohë të dytë kushtetuesja do duhej të shprehej mbi regjimin që duhej adoptuar, ai parasheh konflikte mes republikanëve dhe monarkistëve, të rrezikshme për Shqipërinë duke pasur parasysh papjekurinë politike të saj”.²⁹

Por, Perricone nënvizonte edhe dy çështje të tjera, po kaq të rëndësishme. Ai nuk arrinte të vërtetonte se qeveria Ypi ishte filoserbe, por nënvizonte shqetësimin dhe pakënaqësinë se kjo qeveri kishte tendencën të mbante marrëdhënie të mira me të gjithë duke përfshirë dhe Beogradin dhe se, duke qenë asnjënjëse, do t’i linte fushë të lirë konkurrencës së Fuqive të Mëdha, Francës e Anglisë përmes shteteve ballkanike dhe do të sfidonte supremacinë e Italisë. Kështu, siç shprehej Perricone, pjesa e luanit nuk do t’i takonte më italianëve. Perricone informonte se konsulli jugosllav Vukotić, duke biseduar me një nga paria

²⁷ AMAE, Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 707, f. 027998-028005. Telegram postar i kapitenit të Korvetës U. Perricone drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, Shkodër, 9 janar 1922.

²⁸ *Po aty.*

²⁹ *Po aty.*

shqiptare, gjatë një pritje në mensën e oficerëve italianë, i pyetur shprehimisht mbi mundësinë e rifillimit të komunikimeve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, kishte thënë se, meqë më në fund në Tiranë ishte krijuar një qeveri që jep besueshmëri serioziteti dhe stabiliteti, marrëdhëniet me Jugosllavinë do të përmirësoheshin me shpejtësi dhe do të ishte e mundur së afërmi rivendosja e komunikimeve dhe trafikeve, me leverdi të ndjeshme të të dyja vendeve. Kjo, mesa duket, është edhe tendenca e kabinetit aktual, deklaronte nëpunësi italian në Shkodër.³⁰

Nga ky raport, del i qartë, predispozicioni aspak miqësor i qeverisë italiane ndaj kësaj qeverie të dominuar nga “Krahu Kombëtar”, “Partia Popullore” dhe Ahmet Zogu. Aryeja kryesore e kësaj kundërshtie, siç e bënte fare të qartë Perricone, ishte politika miqësore dhe afrimi në mënyrë të barabartë kundrejt të gjithë fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha. Kurse, Roma donte të siguronte monopolin e saj në Shqipëri duke përjashtuar të tjerët. Kështu, Roma do ta kuptonte se dështimi i grushtit të shtetit, i kishte dëmtuar edhe më tej interesat e saj monopoliste në Shqipëri. Ndaj, ajo nuk do t’i hidhte armët dhe nuk do të reshte së luftuari për ndryshimin e situatës politike, në favor të saj. Arma më e preferuar ishte mbështetja e grupeve të veçanta të opozitës shqiptare por, edhe e përçarjeve brenda “Partisë Popullore” përmes nxitjes së intrigave të ndryshme.

Në përfundim të këtij raporti, Perricone theksonte se “qeveritë e Tiranës dhe të Beogradit janë duke vepruar, me asistencën e pamungueshme të Francës dhe, sipas gjasave, të kombeve të tjerë pseudo albanofilë, me qëllim që sukseset tona në Shqipëri të arrijnë të neutralizohen, dhe ajo të bëhet fushë shfrytëzimi për të gjithë. Dhe nëse do të jetë kështu, është evidente që pjesa e luanit nuk do të na takojë ne, që jemi më pak të përgatiturit industrialisht dhe financiarisht për të përballuar konkurrencën e fuqive të tjera të mëdha; edhe pasi, përveçse do të punojnë drejtpërdrejtë, Franca e Anglia do të grumbullonin akaparimet, edhe pas flamujve respektivisht të Jugosllavisë dhe të Greqisë”.³¹

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty.*

Kryengritja e marsit 1922 - sfida më e ashpër e Italisë kundër qeverisë shqiptare

Goditjen që pësoi me grushtin e shtetit, qeveria italiane do të përpiquej ta kompensonte me një veprim edhe më të rrezikshëm e destabilizues për shtetin e ri dhe qeverinë që e drejtonte atë. Duke përfutur edhe nga armiqësitë midis politikanëve shqiptarë si dhe nga situata e tensionuar pas tejkalimit të grushtit të shtetit, me gjithë kompromiset e mundshme që bëri “Partia Popullore” me kundërshtarët e saj, qeveria italiane nxiti dhe mbështeti një kryengritje të fuqishme dhe të rrezikshme antiqeveritare. Deri më sot nuk janë zbuluar të gjitha detajet e kësaj ndërhyrjeje por, disa fakte janë kuptimplotë për ta vërtetuar atë. Në organizimin e kryengritjes luajtën rol parësor politikanë me orientim të qartë filoitalian si: Hasan Prishtina e Mustafa Kruja, të cilët arritën të bindin patriotin veteran Bajram Curri, i cili më parë kishte mbajtur qëndrim kritik ndaj grushtit të shtetit, të përfshihej në të. Përveç kësaj, njëri nga krerët e kryengritjes ishte Hamit Toptani i njohur mirëfilli si element filoitalian dhe që financohej prej tyre. Atëherë, diplomatët britanikë dhe më vonë studiuesit e huaj kanë pohuar me bindje se gjithë këto shpenzime materiale për kryengritjen nuk mund të siguroheshin nga vetë shqiptarët por, ishte një fuqi e huaj që i financonte dhe kjo thuhej troç, se ishte Italia.

Në telegramin e tij, mbi ngjarjet e marsit të vitit 1922, Eyres jep edhe një informacion interesant mbi arsyet e ndërhyrjes që ai kishte bërë për të shmangur konfliktin midis Elezit dhe qeverisë, duke bërë edhe një lloj autokritike, për faktin se kishte vepruar pa udhëzimet e Foreign Office, për arsye të situatës kritike që ishte krijuar.³² Por, menjëherë pas kësaj deklarate të Eyres-it, vijonte një informacion tjetër tepër interesant dhe konfidencial i tij, mbi ndërhyrjen e huaj në mbështetje të segmenteve të caktuara të opozitës shqiptare. Ai informonte, Londrën se “Ju kam dhënë deri tani aspektin sipërfaqësor të çështjes, por çështja interesante, se të cilit ishin lëvizjet e para, është për t’u zgjidhur. Qeveria dhe njerëzit e ndryshëm në rrugë, janë vendosmërisht të bindur se Italia është shtytësja dhe mbështetësja e komplotit. Ato pranojnë se nuk kanë prova dokumentare për t’i vënë këto akuza në letër, por thonë se Bajram Curri

³² TNA, FO 371/7331, f. 427-429. Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, Durrës, 16 mars 1922.

është mik i ngushtë i Italisë, Hasan Bej Prishtina, gjithashtu, dhe se ato nuk kishin burimet e nevojshme për të organizuar një kryengritje kaq të zgjeruar.”³³ Ndërhyrjen italiane e raportonte edhe përfaqësuesi britanik në Komisionin e Kufijve, i cili pohonte: “Shkodra ishte e privuar nga të gjitha komunikimet me anë të tokës me Shqipërinë e Jugut. Përgjatë javës së dytë të marsit, pati tentativë për revolucion nga italoofilët e pakënaqur nga qeveria e fundit, të cilët u financuan me fonde italiane.”³⁴

Siç dihet krijimi i opozicionit në Shqipëri erdhi përmes disa cikleve. Bërthama e parë ishte grupi i politikanëve që kishin qenë mbështetës ose pjesëtarë të qeverisë së Durrësit dhe që u lanë jashtë përfaqësimit politik nga Kongresi i Lushnjës. Të tillë ishin: M. Kruja, L. Bumçi, M. Libohova etj. Më tej opozicioni u pasurua me grupin e politikanëve kosovarë, irredentizmi i të cilëve i çoi në opozicion me politikën e moderuar të qeverive të kohës. Në këtë grup bënin pjesë: Hasan Prishtina, Hoxhë Kadriu, Bajram Curri etj. Ky grup ishte edhe cikli i parë i shturjes së “Krahut Kombëtar”, e cila kishte qenë organizata dominuese në Kongresin e Lushnjës.

Duke e trajtuar më gjerësisht këtë çështje, diplomati britanik R. Parr, më 15 tetor 1923, njoftonte Foreign Office se “Eshref Frashëri dhe jugu mendonin se Shqipëria do të ishte më mirë të shpenzonte pak a shumë 10 vjet në vendosjen e rregullit në shpinë e saj, dhe pastaj të vendoste rihapjen e çështjes së Kosovës. Edhe A. Zogu iu bashkua këtij mendimi. Nga ana tjetër, Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe të tjerë, ndoqën rrugën me të cilën, me intrigat direkte apo indirekte kundra Jugosllavisë, mund të arrinin ta fitonin Kosovën më shpejt. Kjo sjellje, natyrisht i hodhi në duart e Italisë dhe ata kishin shumë gjëra të përbashkëta me partinë e Gurakuqit.”³⁵ Parr shtonte se më pas kishte ndodhur “Kryengritja e Marsit 1922” dhe opozita ishte pasuruar me një grup të ri që ishte shkëputur nga “Partia Popullore”. Ky grup kishte në krye F. Nolin dhe mbështetësit e tij, K. Kirka, S. Vinjau, B. Omari etj.

Në kohën kur një ndarje tjetër ndodhi në “Klikë” dhe kolonel Tatzati, ministri i Luftës, Bedri Peja, Ali Koprencka, Halim Gostivari dhe tre

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*, FO 371/7330, f. 689-696. Ngjarjet nga 1 mars-31 mars 1922. Raport i komisionerit britanik Hiles në Komisionin e Kufijve Serbo-Shqiptarë, mbi tentativën për grusht shteti në Shqipëri.

³⁵ *Po aty*, FO 371/8535, f. 1148-1149. Telegram i Parr për Curzon, mbi situatën politike në Shqipëri, dt. 15 tetor 1923.

persona të tjerë u deklaruan kundër Zogut, ky i fundit u sulmua se ishte shumë miqësor me Jugosllavinë dhe se kishte dështuar në reformimin e administratës së brendshme. Kur e gjetën veten të pazotë për ta hequr atë nga posti i presidentit të Këshillit ose nga Ministria e Punëve të Brendshme, ata u shkëputën (nga “Partia Popullore”). Në këtë kontekst, R. Parr informonte Londrën se “këtu ka arsye për të dyshuar mbi influencën italiane.”³⁶ Kjo është një paraqitje sintetike dhe mjaft korrekte e ecures së opozitës dhe opozicionit në Shqipëri. Siç dihet, pas marrjes së postit të kryeministrit nga Zogu, “Rrymat e nënkuptuara nga Italia dhe Jugosllavia dhe rivendosja e marrëdhënieve mes Gurakuqit dhe mbetjeve të gjysmës së “Klikës”, gradualisht kristalizuan opozitën ndaj tij.

Pas kryengritjes së marsit 1922, qeveria italiane do të vijonte politikën e saj të penetrimit në klasën politike shqiptare dhe nxitjes së konflikteve brenda saj. Pas më pak se një viti qeveria shqiptare do të sfidohej nga një kryengritje tjetër në janar 1923. Grupi kryesor që e realizoi këtë kryengritje ishin irredentistët shqiptarë të Kosovës, me Hasan Prishtinën e Bajram Currin, të cilët në këtë kohë ishin nën ndikimin e fortë italian. Italia e ushqente irredentizmin e tyre dhe armiqësinë kundër qeverisë shqiptare duke i bindur ata se kjo qeveri nuk po bënte sa duhej për kauzën e tyre, për shkak se ajo ishte filojugosllave dhe për pasojë duhej rrëzuar me çdo mjet. Nga ana tjetër, ajo, në mënyrë mashtruese e manipuluese, u premtonte krerëve kosovarë se, nëse ata vinin në pushtet, do t’i ndihmonte për realizimin e qëllimeve të tyre kombëtare, duke e nxitur edhe më shumë frymën opzitare të tyre dhe ashpërsinë e veprimeve kundra qeverisë shqiptare.

Italia faktor kryesor në sfidën kundër qeverisë shqiptare për të penguar dhënien e koncensioneve të naftës shoqërisë britanike “Anglo Persian Oil Company”

Ahmet Zogu dhe kabineti i tij ishin mjaft të vetëdijshëm për nevojën urgjente për reforma drastike në çdo drejtim dhe pavarësisht nga vështirësitë e shumta në rrugën e tyre dhe kundërvënien e interesave ekzistuese, iu futën me vendosmëri kësaj detyre. Gjatë marsit vëmendja e qeverisë u angazhua në drejtim të disa kompanive britanike, amerikane, italiane dhe franceze, duke përfshirë “Anglo-Persian Oil Company”,

³⁶ Po aty.

“*Standart Oil Company*” dhe “*Sinclair Oil Company*” që konkurronin për koncensione në nxjerrjen e naftës.³⁷

Në këtë periudhë një nuancë e re u duk në trajtimin e problemit shqiptar në Lidhjen e Kombeve: nuanca ekonomike e cila u bë shkak për pranimin e Shqipërisë në gjirin e saj. Anglia, duke qenë më realiste për situatën e krijuar në Ballkan, i la prapa fuqitë e tjera duke i kërkuar qeverisë së Iljaz Bej Vrionit “si shkëmbim të pranimit të saj në Lidhjen e Kombeve të drejtën ekskluzive për shoqërinë vajguore anglo-persiane “*Oil Company*” për të kërkuar dhe shfrytëzuar vajgurin në Shqipëri”.³⁸

Është fakt se me hyrjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u zhvilluan bisedime tregtare midis qeverisë angleze dhe asaj shqiptare dhe kur, siç do të shihet më vonë, “të fillojë depërtimi serioz i ekonomisë italiane në Shqipëri një pengesë e madhe do të krijohet pikërisht nga interesat angleze aty”.³⁹

Në këtë kohë, Italia ishte për një veprim diplomatik të përbashkët, të bashkërenditur me palët e tjera të interesuara, për të mos lejuar ratifikimin nga ana e Parlamentit Shqiptar të marrëveshjes së nënshkruar midis qeverisë shqiptare dhe shoqërisë anglo-persiane dhe për të penguar për pasojë, vendosjen e hegjemonisë së monopolit anglez mbi vajgurin shqiptar.

Është më se e kuptueshme që fillimi i investimeve të huaja në Shqipëri në këtë kohë ishte domosdoshmëri politike dhe ekonomike. Konkensionet që duhet të bënte Shqipëria kishin lidhje të ngushtë me situatën e brendshme dhe të jashtme dhe, duke analizuar këtë fakt ishte shumë e vështirë për Shqipërinë pranimi ose refuzimi i njëjës apo tjetrës ofertë, sidomos kur këto shoqëroheshin me presione të hapura. Sidoqoftë, për shkak të presionit të Fuqive të Mëdha, pretenduese për të depërtuar në Shqipëri dhe për shkak të kundërshtimit të opozitës në Shqipëri, deri në vitin 1924 nuk u ratifikua asnjë konçesion nga Parlamenti shqiptar. Një faktor tjetër pengues për këtë procedurë ka qenë edhe mungesa e

³⁷ J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie...*, f. 326-328.

³⁸ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Serie VII (1922-1935), vol. III (24 marzo-22 giugno 1919), Ministero degli Affari Esteri, Roma: Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, Libreria dello Stato, MMVII, 2008, doc. nr. 70/1, f. 436.

³⁹ J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie...*, f. 339.

stabilitetit politik në vend, trazirat e herëpashershme dhe dhunimi i kufijve dhe i tërësisë tokësore të Shqipërisë nga ana e monarkive fqinje.⁴⁰

Në këtë skenar të përgjithshëm dalin në pah interesat e huaja ekonomike në Shqipëri, sidomos ato angleze në fushën e naftës, por nuk mbeten mbrapa edhe ato të Italisë, si më e favorizuara në aspektin politik, duke qenë se një konsensus ndërkombëtar kishte pranuar interesat e saj për sigurimin e daljes në Adriatik. Ndërkohë, qeveria shqiptare ndjek qëndrimin për të mos bërë asnjë kompromis me fuqitë e huaja duke konsideruar Britaninë e Madhe si partnerin kryesor në aspektin politik, ndërsa në atë ekonomik Lidhjen e Kombeve, e cila i siguron ndihmën dhe mbrojtjen Shqipërisë. Në këtë mënyrë, kapitali italian dhe pikërisht lobi i fuqishëm i financierëve të mëdhenj italianë e nxiti në këtë situatë qeverinë e Romës që të zhvillonte më tej luftën në Lidhjen e Kombeve për t'i siguruar kapitalit italian ndërhyrjen me epërsi në sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri.⁴¹

Qëndrimi i Italisë ndaj qeverisë së Nolit

Italianët ishin simpatizantë të një pjese të madhe të opozitës që kishte ardhur në pushtet. Ata kishin disa përkrahës të tyre në radhët e saj dhe ka shumë të ngjarë që të kishin sponsorizuar disa veprime të dhunshme opozitare në momente të caktuara, ndoshta edhe të kryengritjes së fundit.

Dyshimet për mbështetjen italiane ndaj kryengritjes së qershorit ishin të mëdha. Këto i pohonte edhe përfaqësuesi britanik, Parr, i cili shtonte këtu edhe ndërhyrjen e bolshevikëve, të cilët shumë shpejt, pas triumfit të kryengritjes, filluan të mbështesnin grupe të tjera të ish-opozitës, për të përmbysur Nolin. Në lidhje me këto ngjarje Parr shkruante: “Siç ka qenë zakon në Shqipëri, revolucioni i fundit i dedikohet interesave të një fuqie të huaj. Shumica e njerëzve mendon se Italia ka dorë në të gjitha lëvizjet revolucionare. Gjithashtu opinioni publik ka arritur një konkluzion të ngjashëm, për faktin se sovjetikët ishin në themel të këtyre ngjarjeve. Thuhet gjithashtu, që Fan Noli është subvencionuar, në fillim, nga bolshevikët, por që tashmë, ata janë duke subvencionuar të tjerë, me shpresën për ta rrëzuar atë. Ky fakt bëhet i besueshëm, për sa kohë që

⁴⁰ Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1924*, Tiranë: UET Press, 2013, f. 45-46.

⁴¹ *Po aty*, f. 46-47.

“Klika” dhe ministrat e Luftës dhe të Brendshëm gëzojnë një gjendje financiare private të begatë dhe janë gati të shqetësojnë qeverinë aktuale. Kësaj i shtohet edhe fakti se, qeveria e re dhe administrata e saj, duket e pa zonja në parandalimin e komitaxhinjve bullgarë në jug dhe atyre malazezë në veri, që kalojnë kufirin sa herë dëshirojnë. Sigurisht, kjo mund të jetë rezultat i pazotësisë së qeverisë dhe jo i simpatisë për të ashtuquajturit komitaxhinj dhe kjo është një pjesë e dështimit të qeverisë ... Këto dështime janë pronë e secilit dhe shpejtësia e përfundimit të regjimit aktual është lirisht e parathënë. Anëtarët e këtij regjimi, po ashtu edhe mbështetësit e tij, gjatë mosmarrëveshjeve midis tyre, duke dhënë shpjegime publike në lidhje me lirinë e tyre private, vazhduan të godisnin në kafene dhe në gazeta, të gjitha ato fuqi që nuk i kishin njohur ato si një fuqi legjitime në Shqipëri”.⁴²

Që në momentet e para, qeveria italiane, e ndoqi me kujdes situatën e qeverisë së re. Legata italiane e lidhte në mënyrë jetike, domosdoshmërinë e legjimitimit të qeverisë shqiptare për njohjen ndërkombëtare të saj, e cila ishte kushti themelor për trajtimin e çështjes së koncesioneve dhe huave që do merrte shteti shqiptar, të cilat ishin jetike për ekzistencën e tij. Po për të njëjtën arsye, kjo ishte edhe premisa kryesore që qeveria italiane ta mbështeste këtë qeveri, për të cilën ishte e predispozuar më pozitivisht se sa kundrejt gjithë qeverive të mëparshme.

Mirëpo, marrja e postit të kryeministrit nga Noli, edhe pse e formuluar brenda ligjit, ishte në kundërshtim të plotë me Statutin e Lushnjës dhe për pasojë, tërësisht e paligjshme. Ndërsa deklaronte se Këshilli i Regjencës e kishte autorizuar të formonte një qeveri të re, njoftimi zyrtar dërguar përfaqësuesve të huaj, i kushtonte pak vëmendje faktit se përderisa në Shqipëri ishte vetëm një anëtar i këtij Këshilli (Sotir Peci), sipas nenit 49, regjencia nuk mund të funksiononte. Pra, përveç dobësive të tjera të qeverisë, ishte krijuar një vakuum i rrezikshëm institucional, si rezultat i shkatërrimit dhe shpërbërjes së dy shtyllave kryesore institucionale të shtetit: Parlamentit dhe Këshillit të Naltë ose Regjencës.

Këtë fakt e vinte në dukje edhe legata italiane. Në lidhje me procedurën që u ndoq për krijimin e kësaj qeverie, ministri italian, Durrazo shkruante:

⁴² TNA, FO 371/7330, f. 875-877. Telegram i Parr dërguar MacDonald, mbi qeverisjen e Nolit, 28 korrik 1924.

“Detyra e Fan Nolit për të formuar qeverinë e re i është dhënë vetëm nga një e katërta e anëtarëve të Këshillit të Naltë të Regjencës. Nga tre të tjerët, njëri ishte në prag të dorëheqjes dhe dy të tjerët u arratisën. Është gjithashtu e vërtetë që art. 51 i Statutit provizor parashikon që kur një ose më shumë nga anëtarët e Këshillit të Regjencës ndodhet në pamundësi, për shkak vdekje, sëmundje të pashërueshme ose dorëheqje, në ushtrimin e mandatit të tyre, edhe një nga anëtarët e vetëm, sipas shpirtit të Statutit, mund të ruajë vazhdimësinë e pushtetit të sovranit, por artikulli nuk e përmend rastin e largimit nga vendi të anëtarëve të Regjencës, pa dhënë dorëheqjen. Nga ana tjetër, Statuti përcakton se Parlamenti duhet të mblidhet sa më shpejt të jetë e mundur për të vazhduar me zgjedhjen e anëtarëve që mungojnë.”⁴³

Durrazzo theksonte se, *“gjëja më e rëndë është mos veprimi për të thirrur Asamblenë Kushtetuese për të miratuar kabinetin e ri”*. Art. 66 i Statutit provizor përcakton se *kabineti i ri ka për detyrë të prezantohet përpara parlamentit, jo më vonë se tre ditë pas emërimit, për të paraqitur programin e tij dhe për të kërkuar votëbesimin. Në rast të kundërt, do të konsiderohet se ka marrë mosbesimin, gjë që sjell rënien e kabinetit dhe dhënien e një detyre të re nga ana e Këshillit të Regjencës”*.⁴⁴ Sipas ministrit italian, këto ishin *“dy parregullsitë më të rënda të qeverisë së re nga pikëpamja konsitucionale.”* Prandaj, edhe ai mendonte se, mënyra më e mirë për të evituar vështirësitë që u përmendën më sipër, do të ishte ajo e thirrjes sa më shpejt të Asamblesë Kushtetuese, punët e së cilës u ndërprejnë nga kryengritja dhe e marrjes së votëbesimit. Durrazzo mendonte se kabinetin e Nolit mund ta fitonte votëbesimin në Asamble, pasi qeveria e re, kishte mundur të merrte një numër deputetësh pak më të vogël nga shumica e anëtarëve që përbënin Asamblenë. Ai besonte gjithashtu, se ajo do mund të emëronte të tre regjentët që mungonin dhe t'i jepte qeverisë fuqi të plotë për tre ose gjashtë muaj.

Akoma më i rëndësishëm ishte informacioni që jepte Ministri italian për faktin se përse qeveria e re kishte refuzuar deri në këtë kohë të ndiqte një rrugë të tillë? Ai shkruante:

⁴³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 163, viti (më tej: V.) 1924, dosja (më tej: D.) 22, fl. 67-70. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, Durrazzo, mbi gjendjen e qeverisë së re shqiptare nga pikëpamja konstitucionale, Romë, 30 qershor 1924.

⁴⁴ *Po aty.*

“Nga diskutimet e bëra nga Fan Noli, Gurakuqi dhe të tjerë, kam mundur të kuptoj se një nga shqetësimet më të mëdha të tyre, ishte fakti se Asambleja mund të dilte në shumicë kundër shkrirjes së saj, pasi të kishte përmbushur, në dy ose tre seanca, detyrat e saj, ndërkohë që qeveria e re donte të evitonte me çdo kusht vazhdimin e bashkëpunimit me këtë Asamble, kështu siç është e përbërë ajo dhe se Asambleja ishte jashtë mase jopopullore.”⁴⁵

Ky është një zbulim shumë i rëndësishëm që shpjegon shumë gjëra nga politika anti konstitucionale e qeverisë së Nolit.

Po kaq interesant ishte edhe informacioni që jepte Durazzo, mbi mënyrën se si kishte menduar qeveria ta kapërcente këtë situatë, duke e nxitur Asamblenë Kushtetuese të vetëasgjësohej. Ai shkruante:

“Qeveria ka si qëllim, me sa duket, të mbledhë nga të gjithë anëtarët e Asamblesë që janë ndjekësit e saj, deklaratat me shkrim të dorëheqjeve. Kur shumica e anëtarëve të Asamblesë të kishte dhënë dorëheqjen, ishte e qartë se pakica nuk do të ishte më në gjendje të merrte asnjë vendim e kështu që nuk mund të thirrej më. Asambleja Kushtetuese shqiptare në këtë mënyrë do të kishte vrarë veten. Kjo do të sillte nevojën për qeverinë, e cila do të mbetej detyrimisht fuqia kryesore, për të thirrur sa më shpejt zgjedhjet elektorale. Por duket se qeveria nuk ka ndër mend t'i bëjë ato para marsit tjetër, dhe më e shpejta, dhjetorit që vjen.”⁴⁶

Pra, duket qartë, se ekzistenca e Asamblesë konsiderohej si pengesë dhe shkatërrimi i saj, si objektivi i qeverisë, pavarësisht se në këtë mënyrë, vendi do të humbiste institucionin themelor legjislativ. Kjo provon katërcipërisht, synimin e Nolit dhe përkrahësve të tij, për të shkatërruar demokracinë dhe për të ndërtuar një qeverisje pa opozitën, e cila tashmë ishte dëbuar me dhunë dhe nuk mund të konkurronte në zgjedhjet e ardhshme. Ministri italian informonte më tej se: *“Çështja akoma po debatohet, po në qoftë se kjo do të ishte zgjidhja, është e qartë se qeveria e re shqiptare, edhe nëse njihet nga Fuqitë, nuk mund të konsiderohet, nga pikëpamja konstitucionale shqiptare, veç se një qeveri provizore deri në thirrjen e Asamblesë së re.”⁴⁷*

Më tej, telegrami nënvizonte në mënyrë të qartë, vështirësitë që do të kishte kjo qeveri, në gjetjen e mbështetjes financiare, për shkak të

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty.

mungesës së ligjshmërisë së saj nga pikëpamja konstitucionale. “Ekziston rreziku që qeveria e re e Tiranës të gjejë vështirësi të shumta në këtë fushë, përveç mosmarrëveshjeve të jashtme, me qeveri ose privatë, të cilët do të hezitojnë të marrin përsipër përgjegjësi me qeverinë e re, derisa kjo nuk është rregulluar nga pikëpamja konstitucionale. Në fakt, një qeveri tjetër mund të mos e njohë vlefshmërinë e përgjegjësive të marra nga një qeveri revolucionare”.⁴⁸ Legata shprehte opinionin se qeveria e Tiranës duhej të futej sa më shpejt në rrugën e legalitetit dhe shtonte se kjo çështje, për fat të keq, ishte paragjykuar nga sjellje të caktuara dhe prej veprimeve të ndërmarra nga qeveria e re, që kur ajo erdhi në fuqi.

Çështja e domosdoshmërisë së marrjes së kredive, ndihmave ekonomike dhe miratimi i koncesioneve ekonomike, midis të cilave, më i rëndësishmi dhe jetiku ishte ai i burimeve vajguore, ishin disa herë më të rëndësishme dhe emergjentë se sa njohja formale vetëm për qëllime diplomatike. Qeveria e re, që të zbatonte reformat e saj të premtuara, e kishte absolutisht domosdoshmëri jetike këtë politikë. Por, ndjekja me sukses e saj, ishte e varur krejtësisht nga legalizimi i qeverisë, përmes zgjedhjeve të reja ose përmes Asamblesë Kushtetuese, tashmë të shpërndarë, pasi asnjë kompani e rëndësishme dhe asnjë qeveri që do të qëndronte pas saj, sado qëllime pozitive të kishin ndaj qeverisë së Nolit dhe sado interesa të kishin në sferën e biznesit me Shqipërinë, nuk do të pranonin t’i nënshkruanin dhe t’i vinin në jetë marrëveshje të tilla, pa fituar qeveria legjitimitetin e duhur. Ky ishte një rreth vicioz, në të cilin qeveria e kishte futur veten dhe ajo hezitonte të dilte prej tij, duke adaptuar njërën prej zgjidhjeve të përmendura më lart.

Sipas pikëpamjes së vëzhguesve të huaj, fakti që qeveria e Nolit mbeti revolucionare dhe e palegjitimuar, ishte një arsye e rëndësishme për mbështetjen e drejtuesve të qeverisë paraardhëse që ndodheshin në mërgim, nga faktorët më relevantë ndërkombëtarë. Shumica e fuqive, pranuan se rrëzimi i qeverisë së Vrionit kishte qenë i paligjshëm. Këtë e kishte parasysh edhe Roma por ajo fillimisht qëndroi në pritje me shpresën se qeveria e re do të vepronte në vijën e duhur të forcimit të pozitave të saj. Por, më tej, kur pa se kjo nuk ndodhi, ajo jo vetëm që u përmbajt nga dhënia e ndihmave asaj por filloi në fshehtësi të zhvillonte kontakte edhe

⁴⁸ *Po aty.*

me emisarët e A. Zogut, duke mos dashur të humbiste asnjë nga shanset e saj për të shtrirë ndikimin mbi këtë të fundit.

Më 21 korrik, u duk se, Roma do ta njihte qeverinë e Nolit. Telegramit me të cilin Fan Noli kishte njoftuar drejtpërdrejt Musolinin, mbi krijimin e qeverisë së re, diktatori italian i përgjigjej në këtë mënyrë:

*“Falë kortezisë dhe kujdesit, me të cilin mora dijeni, për detyrën që iu është ngarkuar nga Këshilli i Regjencës, për të ndërtuar qeverinë e re shqiptare; duke parë me kënaqësi qëllimet e përgjithshme miqësore dhe raportet e fqinjësisë së mirë me shtetet fqinje, ju lutem të keni përgëzimet më të sinqerta që jepen në emër edhe të Qeverisë, dhe sigurinë se Italia do të vazhdojë, si në të shkuarën, të kontribuojë në zhvillimin paqësor dhe prosperitetin e vendit dhe të vendeve fqinje”.*⁴⁹

Legata italiane, e konsideroi telegramin e Musolinit, si një siguri për njohjen dhe ajo kishte besim se qeveria e re do ta legjitimonte pozitën e vet. Në një nga raportet e saj thuhej: “Telegrami i Musolinit drejtuar presidentit të ri të Këshillit Monsinjor Fan Nolit, të cilit iu bë publiciteti i madh, u redaktua në terma më miqësorë. Kjo është prova e qëllimit të mirë të qeverisë sonë, rreth çështjes së njohjes së qeverisë së re nga ana e Fuqive. Mund të thuhet se pas një telegrami të tillë, njohja nga ana jonë është siguruar. Tek e fundit, kjo çështje nuk mund të ketë veçse një rëndësi të përkohshme dhe më tepër formale. Siç parashikohet, qeveria e re do të arrijë të stabilizojë situatën në një kohë të shkurtër, pak më parë e pak më vonë, të gjitha Fuqitë do të njohin një shtet të ri, që është kthyer në një shtet ligjor. Fuqitë nuk mund të jenë veçse të interesuara në ekuilibrin ballkanik dhe për paqen e përgjithshme.”⁵⁰ Edhe në Tiranë, kjo u interpretua si një njohje, por koha do të dëshmonte se nuk ishte kështu. Arsyeja kryesore e këtij dështimi, do të ishte paaftësia e qeverisë së Nolit të stabilizonte situatën e brendshme dhe të legjitimonte veten, dy pritshmëri që legata italiane dhe, mesa duket, edhe qeveria në Romë, kishin menduar se do të realizoheshin. Pra, nga ky telegram dhe nga ajo që ndodhi më pas, rezulton se edhe italianët nuk e kishin llogaritur mirë dobësinë e forcave që kishin ardhur në pushtet dhe u befasuan prej paaftësisë së tyre për të konsoliduar pozitat e veta.

Në Romë, një gjë e tillë, u kuptua vetëm disa ditë më vonë. Më 13 korrik 1924, Ministria e P. të Jashtme Italiane, ishte e deziluzionuar me

⁴⁹ *Po aty*, fl. 43. Telegram i Musolinit dërguar Fan Nolit, 21 korrik 1924.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 54-56. Shkëmbimi i pikëpamjeve italo-jugosllave në lidhje me Shqipërinë.

gjendjen në të cilën ndodhej qeveria e Nolit. Ajo e përshkruante kështu situatën: “Qeveria, e cila nuk ka mundur, ose nuk ka shfrytëzuar sa duhet mundësitë për të rregulluar jo-konstitucionalitetin e saj pas ardhjes në fuqi, siç shprehej Durazzo në raportin e tij të 30 qershorit nr. 152, tashmë gjen vështirësi më të mëdha për të hyrë në rrugën e kushtetutshmërisë. I vetmi anëtar i mbetur nga katër regjentët, Sotir Peci, u largua nga Tirana, për arsye shëndeti (ka që thonë përkundrazi për mosmarrëveshje me qeverinë) dhe kështu pushteti i Këshillit të Regjencës, në këtë pikë sipas kushtetutës, i kaloi Presidentit të Këshillit të Ministrave. Asambleja Kushtetuese as nuk është mbledhur e as nuk është shpërndarë, akoma nuk janë arritur dorëheqjet e shumicës. Nga ana tjetër, zgjedhjet akoma nuk janë shpallur, dhe nuk parashikohen të shpallen. Duke mos u informuar mbi direktivat e Durazzos, mua m’u duk e përshtatshme t’i tërheq edhe një herë vëmendjen si Fan Nolit ashtu edhe Gurakuqit, mbi domosdoshmërinë e rregullimit të situatës së qeverisë, qoftë edhe formalisht, nga pikëpamja konstitucionale. Ata nuk e bëjnë, e mbase nuk mund ta bëjnë këtë gjë. Por, kjo i jep shanse dhe armë në dorë armiqve të tyre.”⁵¹

Në fakt, Italia ishte në mëdyshje për të ndërhyrë dhe mbështetur hapur aleatët e saj që kishin ardhur në pushtet por, u druajt sepse kjo mund të shkaktonte ndërhyrjen e fuqive të tjera dhe aksioni i saj do të dështonte, çka mund të kishte pasoja për interesat afatgjata italiane në Shqipëri. Afera e njohur për furnizimin e qeverisë së Nolit me armë, ndonëse nuk rezultoi e suksesshme për shkak të gabimeve dhe të dobësisë ekstreme të qeverisë së Nolit dhe shpejtësisë së rrëzimit të saj, mbetet një provë mjaft domethënëse për këtë qëndrim të qeverisë italiane. Nga ana tjetër, ka shumë gjasa se nga informacionet që mori përmes emisarëve të saj, Farnezina shpejt erdhi në përfundimin se kishte më shumë shanse për sukses duke arritur një marrëveshje me Zogun, i cili premtojte një qeverisje më të qëndrueshme në Shqipëri. Fatmirësisht, ky qëndrim i Italisë dhe pozicionimi i Fuqive, për të mos lejuar ndërhyrjen e saj, pengoi edhe fqinjët ballkanikë, nga ndonjë ndërhyrje në Shqipëri.

Siç dihet, lëvizja e Nolit nuk ngjalli asnjë entuziazëm tek Fuqitë e Mëdha demokratike perëndimore, si një lëvizje që jepte shpresa se mund të ndërtojte një qeverisje demokratike në Shqipëri. Përkundrazi, ajo dha prova të një autoritarizmi edhe më brutal se sa qeveritë e mëparshme.

⁵¹ *Po aty*, fl. 75-78. Situata e brendshme në Shqipëri dhe çështja e njohjes ndërkombëtare.

Ndryshe nga Londra, në Romë nuk ishin të merakosur për karakterin demokratik ose jo të qeverisë së Nolit. Roma ishte e prirur ta mbështeste qeverinë e Nolit pasi brenda saj kishin ndikim të fuqishëm aleatët e Italisë. Ajo shpresonte dhe dëshironte vetëm që qeveria e Nolit të fitonte legjitimitetin e nevojshëm minimal dhe një farë qëndrueshmërie fillestare për ta mbështetur atë. Por, ishte paaftësia e qeverisë shqiptare për t'i realizuar këto dy objektiva kryesore që ndikoi shumë, në vendimin e Romës zyrtare për të mos u ngutur në njohjen e kësaj qeverie.

S u m m a r y

THE ITALIAN INFLUENCE ON THE POLITICAL CRISES OF 1920-1924

After the National Congress of Lushnja and the creation of S. Delvina's government, the Italian government realized the new political situation and built its strategy for influence in Albania based on two main lines: to fulfill its diplomatic and military objectives and to have greater leverage over the Albanian political class.

Once the war for Vlora ended, the Italo-Albanian agreement of 2 August 1920 was signed and further ahead after the decision of the Conference of Ambassadors of 9 November 1921, the Italian attitude towards the Albanian political fractions was characterized by the continuous political pressure and attempts to establish a pro-Italian government in Albania. To this end, it indirectly opposed the creation of any other government, even a neutral one, making this the dominant Italian political action towards Albania at the time. This policy and interference had a great impact on the political life of Albania, inciting internal strife and left the Albanian state unstable and fragile.

This article will particularly elaborate the above mentioned arguments.